



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.13.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikrat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Rahovecit në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Mehmet Muçaj (Udhëheqës Ekipi), Faik Thaqi dhe Elvir Krasniqi (anëtarë të ekipit).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	8
2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak	13
4 Qeverisja	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP.....	28
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	31
Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it.....	34


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2014, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmorr në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit të datës 01.12.2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra/shërbime dhe subvencione vlerën 191,613€. Investimet kapitale janë mbivlerësuar për 191,613€ si dhe nga keq klasifikimi i njëjtë Mallrat dhe Shërbime janë nënvlerësuar për të njëjtën shumë.

Në nenin 13, Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit- hyrja dhe dalja e parasë së gatshme (në shtyllën e buxhetit final), janë të nënvlerësuar për 67,554€. Më tej, donacionet janë prezantuar në shumën 30,000€ në kolonën e ekzekutimit, derisa duhej të ishte 15,844€.

Theksimi i Çështjes


Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosja e Pasurive Fikse nuk është e plotë, pasi që regjistri kontabël nuk përfshinë 28 automjete komunale.


(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).


Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës ka të dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të kënaqshëm, megjithëse sistemi ka nevojë për një monitorim të shtuar, për të siguruar se kontrollet e brendshme veprojnë me efektivitet dhe efikasitet.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:







Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi për vitin 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Menaxhmenti i Komunës. Përgjigjet e Menaxhmentit lidhur me çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar janë dhënë në detaje në Aneksin III.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari:

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicioj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të komunës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe sistemin e kontrollit të brendshëm.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para përgatitjes së PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), për PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm lidhur me PVF-të është se janë identifikuar disa gabime tek prezantimi i buxhetit final, keq klasifikimi i shpenzimeve, regjistrimi jo i saktë i pasurive, ndërsa sa i përket kërkesave të raportimit ato ishin plotësuar.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra/shërbime dhe subvencione vlerën 191,613€. Investimet kapitale janë mbivlerësuar për 191,613€ si dhe nga keq klasifikimi i njëjtë Mallrat dhe Shërbime janë nënvlerësuar për të njëjtën shumë.

Në nenin 13, Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit- hyrja dhe dalja e parasë së gatshme (në shtyllën e buxhetit final), janë të nënvlerësuara për 67,554€. Më tej, donacionet janë prezantuar në shumën 30,000€ në kolonën e ekzekutimit, derisa duhej të ishte 15,844€.

Theksimi i Çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosja e Pasurive Fikse nuk është i plotë, pasi që regjistri kontabël nuk përfshinë 28 automjete komunale.

(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në memon tonë të planifikimit të auditimit, të dërguar me 01.12.2014, është identifikuar vetëm një rrezik domethënëse lidhur me plotësinë e pasurive dhe prezantimin e tyre në PVF. Në fazën e ndërmjetëm të auditimit ne kemi dhënë këshillën që pasuritë duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël dhe në fazën vijuese të auditimit kemi vërejtur se komuna ende nuk kishte marrë veprimet e duhura për të regjistruar të gjitha pasuritë në regjistrin kontabël.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Mos regjistrimi në SIMFK i të gjitha pasurive në pronësi të Komunës do të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për të dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurisë. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që vlera e pasurive në PVF të ishte e saktë dhe e plotë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar, sepse Menaxhmenti edhe përkundër veprimeve të marra gjatë vitit, nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm. Ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë jo të plota, pasi që në SIMFK nuk janë të regjistruar 28 vetura dhe disa prona komunale.

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë- Kryetari duhet të themeloj një komision të përfaqësuar nga sektorët kryesor të komunës, në të cilin ne do të sugjeronim edhe një zyrtar nga Drejtoria Komunale e Kadastrit, dhe të kompletoj regjistrimin e të gjitha pronave të paregjistruara. Ky komision duhet të përgatit një Raport përmbledhës ku do të raportoheshin rezultatet e regjistrimit dhe sfidat eventuale, dhe t'i paraqet menaxhmentit. Rol kyç në këtë proces duhet të ketë zyrtari i pasurisë, i cili duhet të bëjë regjistrimet e ofruara nga ky komision në SIMFK. Një monitorim sistematik i këtij procesi ka nevojë të bëhet direkt nga Kryetari i Komunës.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna duhet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ajo kishte përmbushur kërkesat raportuese si në vijim:

- Pajtueshmërinë me Rregullës Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Nëse PVF janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF) brenda kornizës kohore;
- Nëse PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- Nëse PVF janë pranuar në gjuhën shqipe; dhe
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe tek Ministri i Ministrisë së Financave (MF) gjatë vitit 2014.

Komuna kishte përgatitur PVF brenda afatit ligjor dhe ato i kishte modifikuar dhe më 19.03.2015 dhe i kishte dorëzuar në MF.

Çështja 2 - Procesi i përgatitjes së PVF - prioritet i lartë

- E gjetura** Në nenin 13 të Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit- hyrja e parasë së gatshme, në shtyllën e buxhetit final, të hyrat komuna i ka prezantuar më të ulëta për 67,554€. Vlera e prezantuar ishte 950,000€ ndërsa duhet të jetë 1,017,554€;
- Te neni 13 të dalja e parasë së gatshme në shtyllën e buxhetit final, Komuna ka prezantuar shumën 10,839,000€, ndërsa buxheti final duhet të jetë 10,907,411€. Pra, kemi një mos përputhje 68,411€;
- Po ashtu, të donacionet, në shtyllën e realizimit Komuna ka prezantuar shumën 30,000€ ndërsa duhet të jetë 15,844€; dhe
- Ishin bërë keq klasifikime të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar mallra dhe shërbime, dhe subvencione në vlerë 191,613€.
- Rreziku** Deklara e Kryetarit dhe ZKF-së nuk është plotësisht e besueshme. Paraqitja jo e saktë e të dhënave në PVF dhe gabimeve të identifikuar në shumën e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të Komunës. Shumat e buxhetit të prezantuar gabim në PVF dhe keq klasifikimi i shpenzimeve ishin materiale dhe kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet t'i identifikojë arsyet për keq pohimet e bëra në PVF dhe të siguroj se proceset e rishikimeve përfundimtare nga menaxhmenti do të përmirësohen kur PVF-të e vitit 2015 të dorëzohen. Kryetari dhe ZKF nuk duhet t'i nënshkruajnë deklaratat pa u siguruar se gabimet janë identifikuar dhe korrigjuar, para se PVF të dorëzohen në Qeveri.
-

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte dorëzuar me kohë planin për adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak. Megjithatë, një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë adresuar dhe ende kërkohet kohë deri në adresim të plotë të tyre.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 të Komunës kishte rezultuar me 16 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2014, pesë (5) rekomandim ishin adresuar plotësisht, gjashtë (6) ishin adresuar pjesërisht, dhe pesë (5) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk kishte adresuar një numër të rekomandimeve. Menaxhmenti i Komunës nuk ka zbatuar procese formale të mbikëqyrjes se si rekomandimet po zbatohen. Duke qenë se çështjet e ngritura nga auditimi i kaluar nuk ishin trajtuar sa duhet, shumë nga gabimet dhe dobësitë e vitit të kaluar janë përsëritur edhe këtë vit.
- Rreziku** Dështimi në implementimin e rekomandimeve ka rezultuar me dobësi të vazhdueshme në sistemin e kontrollit të brendshëm. Kjo ka rezultuar me: PVF jo të sakta; mos respektim i plotë i rregullores për ndarjen e subvencioneve, menaxhim i dobët i pasurive dhe përfitim jo të mjaftueshëm nga auditimi i brendshëm.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit nuk do të bëhet sa për të plotësuar një kërkesë formale që del nga auditimi, por do të jetë një udhërrëfyes praktik për zbatimin e të gjitha rekomandimeve. Dokumenti si i tillë do të përcaktoj një afat kohor praktik si dhe personat përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve, me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet nga vet Kryetari, dhe atë në baza të rregullta.

4 Qeverisja

Konkluzion i Përgjithshëm

Qeverisja e fortë mbështetë planifikimin efektiv, implementimin dhe monitorimin e aktiviteteve të komunës. Në aspektin e qeverisjes janë identifikuar dobësi domethënëse. Procedurat e planifikimit buxhetor janë të dobëta dhe si rezultat i kësaj, komuna e Rahovecit për vitin 2014 nuk kishte aprovuar buxhetin në Kuvendin Komunal me kohë. Buxheti nga kuvendi i komunës ishte aprovuar më 26.02.2014. Buxheti i vitit 2014 ishte i njëjtë sikurse buxheti i vitit 2013. Mos aprovimi i buxhetit në Kuvendin Komunal me kohë rritë rrezikun që projektet kapitale të mos përfshihen në buxhetin vijues si dhe fondet e parashikuara sipas kategorive buxhetore, të mos jenë në pajtim me nevojat reale.

Komuna nuk kishte bërë vetë-vlerësimi si dhe nuk kishte hartuar planin për menaxhimin e rrezikut.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi procesin e planifikimit, buxhetimit dhe të hyrave nuk janë të mira dhe nuk janë analizuar në mënyrë të qëndrueshme. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën e Rahovecit, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Për më shumë, të dhënat janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	9,774,525	10,907,411	10,463,701	10,067,841	10,276,518
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,824,525	9,691,929	9,530,093	9,148,202	9,061,614
Të bartura nga viti paraprak ²	0	168,163	166,113	188,362	333,620
Të hyrat vetjake ³	950,000	1,017,555	737,857	680,000	615,107
Donacionet e jashtme	0	29,764	29,638	51,277	266,177

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,132,886€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme (29,764€) të hyrave vetjake të mbledhura për (67,555€) më shumë se planifikimi i tyre dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak (168,163€), dhe rritja e grantit qeveritar për shkak të rritjes së pagave (867,404€). Buxheti final për vitin 2014 ishte ekzekutuar në nivelin 96% të buxhetit të planifikuar, çka në aspektin e ekzekutimit paraqet një performancë mjaft efektive.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimet	2012 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,774,525	10,907,411	10,463,701	10,067,841	10,276,518
Pagat dhe Mëditjet	5,365,372	6,254,282	6,228,063	5,330,305	5,361,722
Mallrat dhe Shërbimet	733,893	770,391	634,577	693,593	939,328
Shërbimet komunale	257,260	257,260	226,174	271,208	292,565
Subvencionet dhe Transferet	100,000	106,128	105,951	93,845	94,141
Investimet Kapitale	3,318,000	3,519,350	3,268,936	3,678,890	3,588,762

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetjake të buxhetuara dhe të shpenzuara

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Ndryshimi më i madh ka ndodhur tek kategoria e pagave dhe mëditjeve. Qeveria e Kosovës nga muaji Prill i vitit 2014 ka marrë vendim për ngritjen e pagave për 25% për të gjitha kategoritë në sektorin publik;
- Ekzekutimi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte vetëm 82% për shkak se MF nuk kishte alokuar buxhetin për 15% për mallra dhe shërbime; dhe
- Një shkallë më e dobët e ekzekutimit të buxhetit vërehet tek Investimet Kapitale, ku në fund të vitit janë regjistruar teprica fondesh prej 7% (rreth 250,000€).

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat	950,000	1,017,555	1,017,555	842,364	800,404

Me qenë se buxheti i komunës për vitin 2014 nuk ishte aprovuar në kuvendin komunal atëherë MF si buxhet të planifikuar për inkasim të të hyrave vetjake e kishte caktuar shumën e njëjtë të vitit 2013 (950,000€) Gjatë vitit 2014, kjo shumë ishte tejkaluar për 67,000€, dhe siç shihet në tabelë, shuma e mbledhur ishte 1,017,555€.

Çështja 4 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2 LMFP - Prioritet i lartë

- E gjetura** Në bazë të vendimeve gjyqësore, për vitin 2014 nga llogaria e komunës së Rahovecit, Thesari kishte ekzekutuar pagesa në vlerë prej 36,008€, dhe 323,550€ në bazë të nenit 39.2 të LMFP, Këto fonde ishin shpenzuar për t'i paguar obligimet e viteve të kaluara të cilat ishin bartur në vitin 2014.
- Rreziku** Shumat e ekzekutuara të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2 të LMFP janë domethënëse për buxhetin e komunës dhe ndikojnë në prishjen e bilancit buxhetor. Pagesat e tilla rrisin rrezikun që projektet e planifikuara të mos realizohen si dhe mund të kenë efekte edhe në aktivitetet tjera të komunës.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të siguroj se do të bëj një planifikim të mirëfillt të buxhetit, të forcoj disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë si dhe do t'i rishikoj të gjitha obligimet e mbetura në mënyrë që të evitoj çrregullimet buxhetore.

Çështja 5 – Programi i Investimeve Publike (PIP) - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk mirëmban dhe azhurnon Programin e Investimeve Publike (PIP). Në dymbëdhjetë raste, ne kemi vërejtur se komuna nuk kishte bërë azhurnimet për projektet në PIP, siç kërkohet me neni 7.2 të ligjit të buxhetit. Ligji parasheh se jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas lëshimit të ndarjeve buxhetore të plota për vitin fiskal 2014, organizatat buxhetore duhet të bëjnë ndryshimet e nevojshme buxhetore për të përmbushur obligimet e pa kryera financiare nga viti paraprak që lidhen me projektet kapitale shumëvjeçare. Një gjë të tillë, komuna nuk e kishte bërë.
- Rreziku** Komuna ka një menaxhim të dobët të këtij programi. Mos planifikimi i mjeteve financiare të mjaftueshme për projektet kapitale për të cilat Komuna ka kontrata, rritë rrezikun që të bëhen shkurtime të detyrueshme në projektet tjera të aprovuara nga Kuvendi, si dhe potencialisht rritë rrezikun që të jetë subjekt i padive gjyqësore.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurohet se për të gjitha projektet shumëvjeçare, planifikimi i buxhetit është bërë në mënyrë konsistente dhe PIP përdoret sipas duhet.

4.2 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Komuna e Rahovecit nuk ka të vendosura kontrole të mjaftueshme që ndërlidhen me mbledhjen e të hyrave vetjake. Ekziston nevoja për përmirësimin e disa proceseve për ta mbështetur mbledhjen e të hyrave. Ne, në fazën e ndërmjetme të auditimit kemi dhënë këshillën që të hyrat të regjistrohen në kode adekuate dhe konsiderojmë se Komuna kishte ndërmarr masa në adresim të kësaj këshille. Përkundër kësaj, ne identifikua çështjet tjera si në vijim:

Çështja 6 – Mosinkasimi i qirave për pronat komunale – prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna e Rahovecit në vitin 2014 nuk kishte ndërmarr veprime konkrete ndaj shfrytëzuesve të cilët nuk kishin kryer obligimet financiare/qiratë për pronat komunale në shfrytëzim afatshkurtër. Ne identifikua dy raste ku kontratat për dhënie e objekteve komunale me qira, ishin me afate të skaduara derisa në fakt shfrytëzuesit e objekteve vazhdojnë t'i shfrytëzojnë ato lokale. Në katër raste identifikua që përdoruesit e lokaleve komunale nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj komunës. Ngarkesa vjetore për katër (4) raste ishte 24,536€, ndërsa borxhet e akumuluar gjatë viteve paraprake ishin 94,227€.
- Rreziku** Kontrollat e aplikuara mbi të hyrat nga qiraja janë jo efektive. Vazhdimi i shfrytëzimit të pronave komunale në mungesë të kontratave valide është në kundërshtim me ligjin. Për më tepër, komuna ligjërish nuk posedon të drejtën të inkasoj qiratë dhe kjo rritë rrezikun që këta obligues financiar të refuzojnë obligimet e tyre dhe të hyrat të mos mblihen fare.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroj që kushtet e arritura të kontratave me qiramarrësit, në mënyrë strikte të zbatohen. Për rastet që vlerësohet se qiratë nuk mund të mblihen, kontratat të ndërpriten dhe të inicohen procedurat e ankandit publik për dhënie e pronave në shfrytëzim.

Çështja 7 – Planifikimi i dobët i të hyrave nga tatimi në pronë - prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna kishte planifikuar të hyrat nga tatimi në pronë 220,000€, derisa faturimin për vitin 2014 e kishte 323,229€. Komuna për vitin 2014 kishte mbledhur të hyra nga tatimi në pronë shumë më prej 301,698€. Nga kjo shihet se procesi i planifikimit nuk i është nënshtruar ndonjë analize të qëndrueshme. Ekzistojnë shpërputhje të larta në mes planifikimit, faturimit dhe inkasimit.
- Rreziku** Si rezultat i analizave të dobëta me rastin e planifikimit, shumat e mbledhura të tatimit në pronë kanë tejkaluar planin prej 37%. Kjo ka ndodhë jo për shkak të efikasitetit të komunës në mbledhjen e tatimeve, por më tepër për shkak të një parashikimi joreal/nënvlerësimit të planit. Gjendja e këtillë vështirëson edhe planifikimin e projekteve për t'u financuar nga burimet vetjake.
- Rekomandimi 7** Me rastin e planifikimit të buxhetit nga tatimi në pronë, Kryetari duhet të siguroj që procesit të planifikimit i paraprinë një analizë e trendeve të realizuara gjatë viteve të kaluara, me theks të veçantë niveli i faturimeve. Përveç kësaj, komuna duhet të zbatoj politika më efektive në mbledhjen e tatimeve.,

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Komuna e Rahovecit për vitin 2014 për kategorinë Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime kishte shpenzuar 4,129,688€. Kemi testuar 66 pagesa në vlerë prej 1,045,116€ apo 25% e shpenzimeve për mallra dhe investime kapitale dhe 10 mostra për aktivitetet e prokurimit në vlerë 1,594,232€.

Testimet tona kanë vënë në pah mangësitë në vijim:

Çështja 8 - Dobësitë sistematike në prokurim - prioritet i lartë

E gjetura Në vitin 2014, Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale më shumë se mjetet e ndara me ligjin për ndarjet buxhetore. Ne identifikua tri raste "Për asfaltimin e rrugës Pastasel-Kaznik", "Ndërtimin e shkollës fillore në Oplotushë", "Ndërtimin e ndërtesës së përbashkët të banimit për familjet në nevojë". Shuma e ndarjeve buxhetore në rastet e cekura më lartë për tri vitet ishte 475,400€ ndërsa vlera e kontratave të lidhura për tri projektet është 1,265,863€. Deficiti i fondeve në raport me kontratat e lidhura ishte 790,463€;

Komuna gjatë vitit 2014 nuk kishte njoftuar me shkrim Operatorët Ekonomik (OE) të eliminuar apo të pa suksesshëm nga tenderi. Ne identifikua 3 (tri) raste që komuna nuk i ka njoftuar OE me shkrim;

Në tre raste të procedurave të prokurimit (për kontratat kornizë) identifikua që Komuna nuk kishte parashikuar në dosje të tenderit sasinë e parashikuar të furnizimeve, ashtu siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik; dhe

Në 19 raste (pagesa), Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve në vlerë totale prej 191,613€. Pagesat ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale, derisa natyra e shpenzimeve ishte subvencione, mallra dhe shërbime.

Rreziku

Hyrja e komunës në kontrata, pa zotimin e mjaftueshëm paraprak të fondeve, të cilat nuk ishin parashikuar me kornizën afatmesme buxhetore, rritë rrezikun që projektet e tilla të vonohen, madje edhe të mos përfundohen. Projektet gjysmë të përfunduara, bartin rrezikun real që të dëmtohen nga kushtet atmosferike dhe të rinovohen para se të jenë dhënë në përdorim. Mos parashikimi i sasisë së përafërt, rritë rrezikun që OE të ofrojnë sasi të artikuljve të panevojshëm dhe çmime çorientuese. Keq klasifikimi i shpenzimeve ndikon në paraqitjen e investimeve kapitale mbi vlerat realisht të shpenzuara në këtë kategori..

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të inicoj kontolle me të mira tek kontaktimet dhe kërkesat ligjore për të siguruar që nuk hyn në obligime kontraktuale, para se fondet buxhetore të jenë zotuar. Zotimet afatgjata duhet të harmonizohen me dinamikën e projekteve dhe të planifikohen me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të komunës. Më tej, njësitë kërkuese duhet të kryejnë vlerësimet e përafërta për qëllime furnizimi/blerjeje në rastet e kontratave të tipit kornizë, dhe procedimi i shpenzimeve të bëhet sipas planit kontabël.

Çështja 9 - Dobësitë jo sistematike në prokurim - prioritet i lartë

E gjetura Komuna nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit për sigurimin e automjeteve komunale. Ne identifikuar që Komuna kishte paguar 2,803€ për sigurimin e 12 automjeteve komunale. Pagesat pa procedurë të prokurimit është në kundërshtim me Rregullën Financiare të Thesarit 01/2013 dhe Ligjin e Prokurimit Publik.

Rreziku Shmangia nga procedurat e prokurimit, rrit rrezikun që komuna të paguaj shërbime më shtrenjtë se sa çmimi i tregut.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të siguroj zbatimin e procedurave të prokurimit për të gjitha rastet kur kjo kërkesë është e aplikueshme.

Çështja 10 - Ndryshimi i Pozicioneve të kontratës në procesin e ekzekutimit të punimeve- Prioritet i lartë

E gjetura Komuna më 02.09.2013 kishte lidhur kontratë për ndërtimin e kanalit të kullimit të tokave bujqësore në fshatin Celinë në vlerë 437,858€. Ky projekt sipas kontratës parashihet të përfundoj brenda tri viteve. Ne kemi identifikuar se gjatë ekzekutimit të kontratës ishin bërë ndryshime substanciale të pozicioneve të kontratës pa aprovim paraprak me shkrim të menaxhmentit të Komunës, por vetëm me pëlqimin e organit mbikëqyrës. Sipas kontratës, kanali është dashtë të jetë i hapur i ndërtuar me beton, ndërsa është duke u ndërtuar si kanal i mbyllur me gypa betoni. Pagesat e bëra deri më tani ishin 80,000€. Për shkak të ndryshimeve të mëdha në kontratë, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri nëse punimet e kryera deri më tani në projekt janë ekuivalente me kundërvlerën e parasë së shpenzuar.

Rreziku Ndryshimi i termave (pozicioneve) të kontratës ka shkaktuar edhe ndryshimin e projektit. Situata e tillë i sjellë në pozitë të pa barabartë ofertuesit tjerë, për shkak se pas ndryshimit të pozicionit të punimeve, edhe çmimet e tyre të ofruara mund të kishin qenë ndryshe nga ato që fillimisht janë dhënë. Kjo rrit rrezikun potencial që çmimi për punët e reja të jetë më i lartë sesa çmimi i konkurrencës. Poashtu rreziku potencial është të mos arrihet qëllimi i projektit. Nuk është e sigurt nëse është fituar vlera për parane, dhe kjo mund t'i shkaktojë komunës humbje financiare.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të rishikoj këtë kontratë dhe të analizoj në detaje arsyet e ndryshimeve të pozicioneve dhe të ndërmer masa të menjëhershme me qëllim që projekti të arrij qëllimin e përcaktuar. Amandamente eventuale në kontrata të vendosen në nivel të parashikueshëm.

4.3.2 Shpenzimet tjera

Çështja 11 - Pagesa përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit - prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2014 kishte nënshkruar disa memorandume të bashkëpunimit. Ne rishikuam përmbajtjen e memorandumeve dhe vërejtëm çështjet si në vijim:

Komuna me 25.04.2014 kishte lidhur Memorandum bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Caritas Kosova për ngritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor shtëpiak dhe ambulantor për qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe në zonat rurale. Vlera e këtij projekti është 70,000€. Komuna sipas marrëveshjes participon me 55,000€. Caritas Kosova në kuadër të këtij projekti do të siguronte një auto veturë me 8 ulëse për nevoja të transportit të personave me regjim dialize. Caritas Kosova nuk e kishte dhuruar këtë veturë dhe nuk kishte kryer shërbime të tilla të cilat ishin në kuadër të marrëveshjes. Komuna kishte paguar në llogari të Caritasit nga kategoria investime kapitale në tërësi shumën sipas marrëveshjes, si në vijim: 30,000€ (12.05.2014); 10,000€ (22.07.2014); 1,781€ (13.10.2014) dhe 13,219€ (04.12.2014). Paratë e komunës Caritas Kosova i kishte përdorur për mbulimin e shpenzimeve për paga të 28 punëtorëve shëndetësor (5 stomatolog, 7 mjek, dhe 16 infermier). Këta punëtorë sipas të dhënave të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) ishin angazhuar në QKMF, Qendër e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe në Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) nëpër zonat rurale. Pagesat të cilat ishin bërë nga Komuna për Caritas Kosova kishin të bashkangjitura vetëm fatura ku te përshkrimi faturës shënon pagesa të lejohet në bazë të marrëveshjes.

Komuna me datën 09.12.2014 ka lidhur aneks kontratë me Caritas Kosova për hartimin e projektit ideor i cili ka për qëllim rregullimin e sallave për shërbime të hemo dializës dhe të kryej komplet procesin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të hapësirave shëndetësore dhe komunale në Rahovec. Vlera e këtij aneksi ishte 20,000€. Komuna participon me 16,782€ ndërsa kontributi i Caritas Kosova do të jetë 3,218€ për shtretër special për repartin e hemodializës, karroca për invalidë, etj.. Komuna kishte paguar në llogari të Caritasit shumën prej 16,781€ me datën 10.12.2014 duke bashkangjitura vetëm fatura ku te përshkrimi i faturës shënon pagesa të lejohet në bazë të aneks marrëveshjes. Për pjesën e participimit nga Caritasi komuna nuk ka ndonjë informacion.

Komuna me 26.12.2013 kishte lidhur marrëveshje me CDF (Community Development Fund) për Sistemi i ngrorjes qendrore në objektin e shkollës fillore në fshatin Xërxe. Në marrëveshje parashihet që komuna të participoj me 17% apo 8,213€. Sipas marrëveshjes komuna do të transferoj në llogari të CDF mjetet para nënshkrimit të kontratës. Komuna me 06.02.2014 kishte paguar në llogari të CDF shumën prej 8,213€ në bazë të marrëveshjes dhe jo me situacione apo ndonjë raport për kryerjen e punimeve. Sipas një raporti, punimet për këtë projekt ishin kryer me 03.03.2014.

Rreziku Rreth 79,000€ ishin bërë pagesa në avans në bazë të këtyre marrëveshjeve. Nuk është e qartë nëse shërbimet/punët e parashikuara në projektet më sipër, janë kryer nga ana e partnerëve. Pagesat e bëra nga komuna pa u kryer shërbimet apo punët, rrit rrezikun që të mos jetë fituar vlera për parane, si dhe projektet të mos përfundohen sipas marrëveshjeve dhe të jenë me cilësi të dobët.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të sigurojë, para nënshkrimit të kontratës, që kushtet për pagesa janë rishikuar për të siguruar një raportim transparent para dhe pas finalizimit të projekteve si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e vlerës për para.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti për kategorinë e paga dhe mëditje ishte 6,245,282€ ndërsa shpenzimi për vitin 2014 ishte 6,228,063€, apo 99.7%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Lidhur me kategorinë paga dhe mëditje rishikuar pajtueshmërinë e kontratave të punës me sistemin e payrollit në Ministrinë e Administratës Publike (MAP).

Rekomandimi

Ne nuk kemi ndonjë rekomandim për këtë fushë.

4.3.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Për vitin 2014, Komuna kishte buxhetin final për subvencione 106,128€, të cilat pothuajse në tërësi i kishte shpenzuar (105,951€).

Ne kemi rishikuar procesin e dhënies së subvencioneve. Pas testimit të një njësie mostre të përzgjedhur prej 9 (nëntë) rastesh në shumë 13,800€, identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja 12 – Mangësi në zbatimin e rregullore për subvencione – prioritet i lartë

E gjetura Komuna nuk kishte respektuar në tërësi rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve. Në vitin 2014 kishte subvencionuar klubin e futbollit “Rahoveci” në shumë 11,300€ pa plotësuar kriteret e përcaktuara në rregullore të brendshme komunale.

Komuna kishte mbështetur SH.K.A “Anadrinia” me 3,500€ për mbajtjen e festivalit tradicional. Sipas rregullore së brendshme komunale subvencionet mbi 2,000€ duhet të aprovohen në Kuvendin Komunal, ndërsa ato ishin aprovuar nga Kryetari i Komunës

Rreziku Dhënia e subvencioneve pa respektuar kriteret e vendosura në rregulloren e brendshme komunale, paraqet rrezik që kontrollet e brendshme të anashkalojnë dhe subvencionet të mos arrijnë objektivat e synuara.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj se rregullorja e brendshme komunale për dhënien e subvencioneve zbatohet në tërësi.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Auditimi ynë ka identifikuar një proces të përshpejtuar të komunës në regjistrimin e pasurive në SIMFK, krahasuar me vitin paraprak. Në PVF e vitit 2013 vlera e pasurive ishte 89,129,219€ ndërsa në vitin 2014 komuna kishte azhurnuar regjistrin e pasurisë dhe vlera e saj është 43,699,997€. Zvogëlimi i vlerës së pasurisë për 45,429,222€. Arsyetimi për këtë ishte se vitin e kaluar disa pasuri ishin mbivlerësuar, si: Shkolla Fillore "Ardhmëria" në Rahovec ishte regjistruar gabimisht me vlerë 50,920,000€ dhe duhej të regjistrohet 509,200€; Shkolla Fillore "Pataqani i ulët", 263,900 ishte regjistruar dy herë; Shkolla Fillore në Kramovik ishte regjistruar dy herë 182,400€; si dhe Shkolla Fillore "Hamëz Thaqi" në Xërxe ishte regjistruar dy herë në shumë 385,106€. Këto azhurnime ishin bërë nga Thesari me kërkesë të komunës.

Në fazën e ndërmjetme të auditimit kemi sugjeruar që të gjitha pasuritë komunale të regjistrohen në pajtim me rregulloren për menaxhimin e pasurisë dhe ne kemi vërejt veprime konkrete që ishin ndërmarrë. Ende mbetet punë për tu bërë në adresim të plotë të rekomandimit. Ne identifikuam mangësitë si në vijim:

Çështja 13 - Mos regjistrimi dhe mos inventarizimi i pasurive - prioritet i lartë

E gjetura Komuna ende nuk ka një regjistër përfundimtar të saktë të pasurive. Nuk ka arritur në fund të vitit të formoj një komision për inventarizim, siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ 02/2013.

Komuna ende nuk ka arritur të përdor dhe regjistroj pasuritë më të vogla se 1,000€ në programin e E-pasurisë. Po ashtu, edhe blerja e tetë auto veturave Dacia Sandero për nevoja të komunës janë të regjistruara si grup me vlerën 50,000€, dhe jo ndaras secila veturë.

Komuna nga 39 automjete që i ka në pronësi nuk ka arritur t'i regjistroj në regjistrin kontabël 28 prej tyre.

Rreziku Mos regjistrimi i saktë i pasurive komunale, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive të komunës dhe paraqitjes jo të drejt të vlerës së pasurisë. Po ashtu, mos regjistrimi i pasurive në programin E-pasurisë rritë rrezikun e humbjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj se në fund të vitit 2015 do të themeloj komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive. Raportet përfundimtare për menaxhmentin, dhe rezultatet e regjistrimit do të procesohen në regjistrat e pasurive nga ana e zyrtarit përkatës. Aktivitetet e komisioneve duhet të mbështeten dhe monitorohen në mënyrë sistematike nga ana e Kryetarit.

4.4.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrimi

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2014 ishin 2,345,000€ dhe krahasuar me vitin paraprak që ishin 2,206,507€, pra kemi një rritje për 138,493€. Këto të arkëtueshme rezultojnë nga: tatimi në pronë, taksat në firmë, dhënia e pronës komunale me qira etj.

Çështja 14 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

E gjetura Ne identifikua që komuna nuk ka prezantuar saktë llogaritë e arkëtueshme për të hyrat nga qiraja në objektet publike, ngase në PVF 2014, të arkëtueshmet e objekteve ishin 146,000€ ndërsa sipas regjistrave komunal ato janë 139,641€.

Rreziku Kontrolli jo i mjaftueshëm ndaj llogarive të arkëtueshme paraqet rrezik që të fshihen nga evidenca obligimet e tatim paguesve dhe kjo do të ndikonte në pakësimin e të hyrave vetjake. Mos arkëtimi i llogarive të arkëtueshme mund të ndikojë në pamundësi për t'i përmbushur planet e shpenzimeve. Politikat jo efikase të komunës për trajtuar llogaritë e arkëtueshme kanë rezultuar në rritjen e tyre nga viti në vit dhe kjo rritë rrezikun e mos realizimit të projekteve komunale.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, mundësive reale për inkasim dhe duhet të bëjë një plan strategjik për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.

4.4.3 Trajtimi i borxheve

Në PVF e vitit 2014, Komuna kishte raportuar obligime financiare në shumë prej 731,551€. Krahasuar me vitin 2013 që ishin 2,202,988€, obligimet ishin zvogëluar për 1,471,437€ dhe vërehet një qasje pozitive në trajtimin e borxheve.

Çështja 15 - Evidentimi i faturave të pa paguara- prioritet i mesëm

E gjetura Komuna e Rahovecit në vitin 2014 kishte mbajtur një evidencë lidhur me faturat e pranuar dhe kishte raportuar obligimet në Thesar në baza mujore. Megjithatë, ne kemi testuar mbajtjen e evidencës dhe identifikuar disa fatura të cilat nuk ishin të evidentuara në librin e protokollit. Vlera e faturave të cilat nuk ishin të regjistruara në librin e protokollit ishte 96,440€ (Fatura me nr. 23/2014 në shumë 26,440€; Fatura me nr. 08/2012 në shumë 40,000€; Fatura me nr. 62 në shumë 30,000€).

Rreziku Mos evidentimi i saktë i obligimeve komunale ndikon që raportimet mujore të mos jenë të plota dhe rritë rrezikun që komuna të paguaj fatura të cilat më herët janë paguar.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj që shërbimi i financave zbaton të gjitha kërkesat ligjore mbi regjistrimin dhe pagesën e faturave të pa paguara.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) përbëhet nga dy auditor. NjAB për vitin 2014 kishte planifikuar t'i kryej 7 raporte të auditimit, plan të cilin edhe e kishte realizuar. Raportet e auditimit të brendshëm në fokus kryesisht kishin aktivitetet e vitit 2013.

Komuna me 12.02.2015 kishte formuar komitetin e auditimit të brendshëm.

Çështja 16 - Auditimi i Brendshëm- prioritet i lartë

E gjetura Auditimi ynë lidhur me veprimtarinë e NjAB ka identifikuar çështjet si në vijim:

Plani vjetor i auditimit të brendshëm ishte bërë në mungesë të një analize për vlerësim të rrezikut;

Vetëm një numër i rekomandimeve të dhëna nga AB ishin adreuarl;

Komiteti i auditimit të brendshëm gjatë vitit 2014 nuk ishte funksional dhe nuk kishte mbajtur asnjë mbledhje; dhe

NjAB në raportet e auditimit të cilat i kishte publikuar gjatë vitit 2014 fokus kryesisht kishte aktivitetet e vitit 2013.

Rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm nuk i kanë ndihmuar menaxhmentit të kuptoj nivelin e veprimeve të nevojitura për të përmirësuar aktivitetet operative dhe financiare.

Rreziku Mungesa e fokusit në ndjekjen e aktiviteteve të vitit aktual, rritë rrezikun që kontrollet e brendshme të mos funksionojnë në mënyrë efektive dhe menaxhmenti të mos jetë i informuar për dobësitë dhe sfidat ekzistuese të kontrolleve. Kjo i pamundëson Kryetarit të Komunës reagimin me kohë dhe marrjen e masave përmirësuese të kontrolleve..

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të siguroj që Sistemi i Auditimit të Brendshëm do të funksionalizohet tutje. Një bashkëpunim i qartë midis palëve të këtij sistemi është i nevojshëm. Fushat e e aduitimit duhet të jenë të bazuara në nivelin e rrezikut dhe të fokusuar në vitin aktual. Kryetari të menaxhoj më mirë rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Palët e treta	Kryetari i Komunës duhet të analizojë arsyet për dështimin në paraqitjen e drejtë të Pagesave nga Palët e treta në PVF-të fillestare dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të tyre në vitin 2014.			Pa adresuar
2. Pasuritë	Kryetari i Komunës duhet të analizojë arsyet për mosparaqitje të plotë dhe të drejtë të pasurive në PVF-të e vitit 2013 dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014.		Pjesërisht	
3. Procesi i përgatitjes së PVF	Kryetari i Komunës duhet të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të dhënave në vitin 2014.		Pjesërisht	
4. Adresimi i rekomandimeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Pjesërisht	

5. Qeverisja e mirë	Kryetari i Komunës duhet të kryejë një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit tek menaxhmenti i lartë, që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të paraqesë zgjidhje të përshtatshme.	Adresuar		
6. Ekzekutimi i buxhetit	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se procesit të përgatitjes së buxhetit i paraprinë një rivlerësim i procesit dhe planifikimi bëhet duke u bazuar në parametra të arsyeshëm dhe real.		Pjesërisht	
7. Të hyrat-planifikimi	Kryetari i Komunës të sigurojë se buxhetimi i të hyrave bëhet mbi bazën e një planifikimi të mirëfilltë dhe të bazuar në parametra real. Po ashtu të bëhet identifikimi i pengesave në inkasimin e të hyrave dhe krijimin e një plani konkret i cili do të rriste shkallën e realizueshmërisë së të hyrave. Menaxhmenti duhet të ndërmerri veprime të menjëhershme lidhur me kontratat e pronave të dhëna me qira dhe inkasimin e borxheve të mbetura. Në të kundërtën, kontratat duhet të ndërpriten dhe shfrytëzimi i pronave publike të ndalohej.			Pa adresuar
8. Lejet e ndërtimit	Kryetari i Komunës të sigurojë se të gjithë përfituesit e lejeve ndërtimore të ngarkohen me shumën e sakta dhe konform ligjit të ndërtimit.	Adresuar		
9. Pronat e dhëna me qira-të hyrat	Kryetari i Komunës të sigurojë se do të bëhet ripërtëritja e kontratave të skaduara dhe faturimi i subjekteve në baza të rregullta mujore. Më tutje, komuna duhet të bëjë qartësimin e të gjitha marrëveshjeve komerciale dhe të anuloi kontratat e pa favorshme për komunën.			Pa adresuar
10. Raportimi i të hyrave	Kryetari i Komunës të sigurojë se procesimi i pagesave nga taksat administrative të bëhet përmes sistemit elektronik dhe të aplikohen barazime mujore në mes të departamenteve përkatëse dhe zyrtarit të të hyrave. Procesi si i tillë, duhet të monitorohet në baza të rregullta.	Adresuar		

11. Shpenzimet Prokurimi	Kryetari i Komunës duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuara janë adresuar.	Adresuar		
12. Shpenzimet	Kryetari i Komunës duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar që një situatë e tillë nuk do të përsëritet.			Pa adresuar
13. Shpërndarja e subvencioneve pa dokumentacion mbështetës	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se çdo subvencion bëhet në bazë të planifikimit dhe me vendim të organeve kompetente, siç përcakton rregullorja e brendshme, procesi të bëhet transparent dhe se subvencionet të jepen vetëm në bazë të kriterëve adekuate, e përcjellur kjo me plan të hollësishëm ideor me qëllim që të zvogëlohet mundësia që fondet e ndara të devijojnë nga qëllimi i paraparë.		Pjesërisht	
14. Pasuritë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë. Zyrtari për menaxhim të pasurisë duhet të regjistrojë dhe mirëmbajë regjistrat e pasurisë sipas Rregullores 02/2013 për menaxhim të pasurisë jo financiare.			Pa adresuar
15. Obligimet	Kryetari i Komunës të sigurojë se obligimet e komunës raportohen në baza të rregullta mujore dhe në përputhje me kërkesat e Rregullës financiare për obligimet e papaguara.	Adresuar		
16. Auditimi i brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se NjAB në të ardhmen duhet të orientohet drejt zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në rrezik të fokusuar në vitin aktual. Kjo do t'i jepte menaxhmentit siguri vjetore për sa i përket efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Duhet të bëhet funksionalizimi i punës së komitetit të auditimit.		Pjesërisht	

Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e ZAP-it
Çështja 2:	Jo	Ne kemi bere përmirësimet në PVF-t mbrenda afatit ligjor dhe kemi dergu në Thesar me dt. 19.03.2015, ku pa u njoftu ne thesari ka leviz shifrat në buxhetin e komunes tone dhe nuk jemi njoftu për kete nderhyrje nga ana e tyre.	Ky është vetëm një arsyetim nga komuna sepse çdo organizatë buxhetore është e obliguar të menaxhoj me buxhetin e vet dhe t'i përcjellë ndryshimet të cilat ndodhin. E gjetura dhe rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
Çështja 7:	Jo	Nuk pajtohemi sepse planifikimi ka qen i imponuar për shkak te mosaprovimin e buxhetit ne Shtator 2013 nga Kuvendi ne komune , edhe pershka te mosaprovimit nga qeveria ne Prill 2014 per shkaqe politike edhe pse kuvendi komunal e ka aprovu me vones.	Ne çështjen e aprovimit të buxhetit e kemi trajtuar në kapitullin te Qeverisja, prandaj theks të veqant i kemi kushtuar planit të të hyrave vetjake respektivisht tatimit në pronë. E gjetura dhe rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar